



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

**VENDIM**  
**Nr. 210, datë 11.10.2019**

**PËR**  
**MOSPRANIMIN E KËRKESËS SË GJYQTARES SUELA XHANI PËR**  
**PËRJASHTIMIN E SAJ NGA LISTA E GJYQTARËVE QË CAKTOHEN PËR**  
**GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA,**  
**TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË FUNKSIONET NË MËNYRË TË**  
**PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 97 të ligjit nr.115 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” bazuar në pjesën VIII, pika 6 të Vendimit nr. 30, datë 14.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e vendimit për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, në kërkesën e datës 03.10.2019 të gjyqtares Suela Xhani, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

**VENDOSI:**

1. Mospranimin e kërkesës së gjyqtares Suela Xhani për përjashtimin e saj nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.
2. Ky vendim t’i komunikohet gjyqtares Suela Xhani, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**